



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljenj/Prodato Received/Delivery	29-01-2024	4	viti god. year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSTAK	532/2024		119



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1520/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Sabile Abdyli -Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1520/2023, të datës 14.12.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike „masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.01.2024, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet** ankesa A.nr.1520/2023, e datës 14.12.2023, e parashtruar nga ankuesi **Anulohet** Vërejtja e datës 20.11.2023, të shqiptuara ndaj ankuesit, ndërsa, çështja **kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje** të organit i cili i ka nxjerrë aktin administrativ të kontestuar.

**II. Obligohet** mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rivlerësimin e çështjes, duke vepruar në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa, obligohet Njësia e Personelit të Administratës Tatimore të Kosovës, që masën disiplinore të anuluar si në pikën I të dispozitivit ta heq nga dosja personal e nëpunësit civil dhe regjistrat përkatës.

**III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

**A r s y e t i m**

Nëpunësi civil, (ne tekstin e mëtejme ankuesi), me datë 14.12.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.1520/2023, kundër masës disiplinore “Vërejtje” të datës 15.11.2023 e shqiptuar ndaj ankuesit, nga Zyrtari i lartë për masa të sforcuara, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit material, respektivisht aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 20.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, me datë 03.01.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 7455/2023 të datës 14.12.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen e datës 20.11.2023; Ankesa e datës 16.02.2022; Akt emërimi AE.582/2022 të datës 06.01.2023 ; Vendimin me numër 582/2022 të datës 23.12.2022; Formulari i Përshkrimit të detyrave të Punës (ATK); Aktemërimi 02/227/09 të datës 21.12.2012 ; Komunikimin elektronike të datës 03.01.2024 24.10.2023, 06.07.2023, 20.10.2023, 16.10.2023, 12.10.2023, 16.10.2023, 21.03.2023, 29.03.2023, 28.02.2023, 18.01.2023, 03.04.2023, 08.05.2023, 07.03.2023, 26.05.2023, 01.06.2023, 05.06.2023, 01.06.2023, 13.06.2023, 18.05.2023, 29.09.2023,14.09.2023, 13.09.2023, 25.10.2023, 31.10.2023, 25.10.2023, 31.10.2023 ndërmjet udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit dhe personave gjegjës në ATK;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka vlerësuar që lënda e ankuesit **të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi** që ka nxjerrë aketet e kontestuara, **sepse:**

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur së ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës dhe se i njëjti sipas Aktit të emërimit me numër AE.Nr.582/2022, të datës 06.01.2023, ushtron pozitën e punës *Zyrtar i mesëm i mbledhjes së detyrueshme*, në Divizionin për Masa të Sforcuara të Mbledhjes/Departamentin për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve.

Tutje, nga shkresat e lëndës rrjedhë së më datë 15.11.2023, Zyrtari i Lart për masa të sforcuara me datë 15.11.2023 ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore “vërejtje”, mbi bazën e dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, gjegjësisht për shkelje disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 , paragrafi 3 nën paragrafin ... ( duke mos pacaktuar nën paragrafë), me shkakun se ankuesi nuk ka zbatuar procedurat komfor Ligjit 03/L-222 për rastet e caktuara nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë ashtu siç parashihen me procedurat e parapara mbi ndarjen e përgjegjësiive (procedurave) në kuadër të DMMB-së. 1. Bizneset që kanë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, trajtimi i bizneseve që janë nëpër gjykatë (vendimet nga gjykata), lista e borxheve kritike dhe të vjetra, intervistës fillestare, identifikimin e personave përgjegjës, vlerësimi i përgjegjësisë për personat e ndërlidhur si dhe konfiskimi për të cilën në vazhdimësi ka kërkuar. 2. Rregullisht është kërkuar që të mbyllen rastet me 0.00, ose qe ka kaluar koha e mbledhjes të delegohen në divizionin tjetër për trajtim. 3. Rregullisht janë përcjell raportet e kualitetit të mbledhjes të cilat kanë konstatuar parregullsia ku nuk është reaguar apo përmirësuar sipas rekomandimeve.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill ndaj masës disiplinore “vërejtje” të datës 15.11.2023, pretendon se nuk qëndrojmë konstatimet si në vërejtje sepse ankuesi brenda viti pavarësisht vëllimit shumë të madh të lëndëve dhe presionit kam trajtuar dhjetar apo qindra raste të cilat janë raportuar edhe aprovuar nga mbikëqyrësi ime. Nga vet shkresa e shqiptimit të vërejtjes shihet se nuk është cekur asnjë rast konkret ku është shkaktuar dëmi apo pasoja nga moszbatimi i procedurave., kërkon që Këshilli te anuloj dhe ta hedhe poshtë masën disiplinore të kontestuar.



Në kuptim të vlerësimit të kompetencës së organit që ka nxjerrë aktin e kontestuar me ankesë, Kolegji i Këshillit ka analizuar masën disiplinore “vërejte”, nga dhe ka gjetur se e njëjta mbanë numër të reference: 01/2023, datën e lëshimit: 15.11.2023, e shqiptuar nga nëpunësi civil në pozitën e Zyrtarit të lart për masa të sforcuara. Kurse, bazuar në provat materiale të përcjella nga organi i punësimit, me asnje dëshmi nuk vërtetohet fakti se shqiptuesi i masës disiplinore është i autorizuar dhe caktuar që të ushtroj detyrën e Udhëheqëset të Divizionit për masa të sforcuara, dhe që do nënkuptonte se i njëjti është mbikëqyrës i drejtpërdrejt i ankuesit, kështu që në mugesë të këtyre dëshmimeve, vërtetimi i kompetencës së organit në shqiptimin e masës disiplinore të goditur me ankesë nuk ka qenë i mundur.

Për me tepër, nga analizimi i masës disiplinore “vërejtje” të datës 15.11.2023, e shqiptuar ndaj ankuesit, Kolegji ka konstatuar se kjo masë është shqiptuar për shkak të shkelje të lehta disiplinore duke iu referuar vetëm nenit 56 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/197 për Zyrtarët Publik, i aplikueshëm nga data 25.09.2023, pa kualifikuar individualisht shkeljen e lehte që pretendohet se është kryer nga ankuesi, ndërsa, bazuar në arsyetimit e dhënë sipas vërejtjes së kontestuar rrjedhë së masa disiplinore Vërejte ishte shqiptuar për shkak të mos zbatimit të detyrave të punës gjegjësisht mos zbatim te procedurave sipas Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat duke specifikuar bizneset që kanë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, trajtimi i bizneseve që janë nëpër gjykatë (vendimet nga gjykata), lista e borxheve kritike dhe të vjetra, intervistës fillestare, identifikimin e personave përgjegjës, vlerësimi i përgjegjësisë për personat e ndërlidhur si dhe konfiskimi për të cilën në vazhdimësi ka kërkuar, mbylla e rasteve me 0.00 borxhe ose qe ka kaluar koha e mbledhjes të delegohen në divizionin tjetër për trajtim, mos përmirësim sipas rekomandimeve të dhëna me raportet e kualitetit të mbledhjes të cilat kanë konstatuar parregullsia. Rrjedhimisht, shqiptuesi i masës disiplinore të kundërshtuar me ankesë vetëm ka shpjeguar përgjithësisht moszbatimin e procedurave ligjore lidhur me fushat specifike, duke mos konkretizuar së cilat biznese kanë qenë nën përgjegjësinë ankuesit dhe për cilat nga to nuk janë ndërmarr procedurat e mbledhjes, duke dhënë shpjegim të qarte lidhur me detyrat dhe afatet e përmbushjes së detyrave.

Referuar kontestimeve si më sipër, rrjedhimisht duke qenë se akti kundërshtuara me ankesë është përfshirë me të meta ligjore, që pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoj që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë, me detyrimin që ky i fundit brenda afatit të përcaktuar si në pikën II të dispozitivit, të bëjë rishqyrtimin e kësaj çështje disiplinore, duke vepruar në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi rrjedhimisht të saktësoj kompetencën lëndore të organit dhe në pajtim me dispozitat e nenit 7, paragrafit 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, të bëjë rishqyrtimin e shkeljeve disiplinore të ankuesit dhe pas kualifikimit të shkeljeve të shqiptoj masën disiplinore për shkelje të lehta disiplinore apo çështjen ta procedoj tek Komisioni Disiplinor në rast të pretendimit se ankuesi ka bërë shkelje e të rënda disiplinore, vërtetimi i të cilave bie në kompetencë materiale të komisionit disiplinor, siç përcaktohet me nenin 58 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/197 për Zyrtarët Publik.

Andaj, theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të*



*cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.1520/2023*

**Sabile AVDYLI**

*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse



**Ardita Haxhnikaj-Demi**

*Ardita Haxhnikaj-Demi*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.